Kronikë

# Arrestohet 49-vjeçari në Shkodër, u kap me armë zjarri, kapsolla detonatore dhe lëndë narkotike (Emri)

*Një 49-vjeçar është arrestuar nga policia e Shkodrës pasi u kap me armë zjarri pa leje, municion luftarak e lëndë narkotike.*



[Sh].com Redaksia
23 Prill, 13:14 | Përditesimi i fundit: 23 Prill, 14:11

Një 49-vjeçar është arrestuar nga policia e Shkodrës pasi u kap me armë zjarri pa leje, municion luftarak e lëndë narkotike.

Forcat blu morën informacione se qarkullonte me armë zjarri me vete, ndaj nisën operacionin dhe vunë në pranga 49-vjeçarin e identifikuar si Ardian Gjergji, banues në fshatin Pistull, Vau i Dejës.


LEXO EDHE:
**Prodhonte detergjentë të paligjshëm dhe të dëmshëm për shëndetin, nis hetimi ndaj një 54-vjeçari**

Gjatë kontrollit në mjetin tip "Volkswagen", që drejtohej nga ai, policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri, me një krehër me fishekë, si dhe një sasi lëndë narkotike cannabis sativa.

Ndërsa në banesën e tij gjetën një armë zjarri automatik, me një krehër me fishekë, 4 krehra, rreth 200 fishekë të llojeve të ndryshme, 26 kapsolla detonatore, 6 detonatorë elektrik, 1 kallëp si ajo e lëndës eksplozive, 2 fitil zjarrpërcjellës dhe një dorezë ebaniti, të cilat u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprat penale "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

A.M./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | Arrestime | lende narkotike | arme zjarri | Ardian Gjergji

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Si e vlerësoni proçesin për zgjedhjen e Presidentit të ri?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë


I droguar në timon, policia vë në pranga 21-vjeçarin në Tiranë! I pezullohet patenta për 1 vit dhe gjobitet me 15 mijë lekë
23 Prill, 14:27

Kronikë

Shpërndante drogë në zonën e Laprakës dhe te Fusha e Aviacionit, arrestohet 31-vjeçari në Tiranë! Iu gjet me vete 1 kg kanabis
23 Prill, 10:38

Kronikë

Kryen manovra me makinë në rrugë dhe dhunuan efektivët që mos t'i shoqëronin në komisariat, 1 në pranga dhe 2 në kërkim në Bulqizë
23 Prill, 09:40

Kronikë

Organizonte baste sportive në lokal, arrestohet 35-vjeçari në Tiranë
22 Prill, 08:47

Kronikë

Përndiqte 16-vjeçaren, arrestohet emigranti 37-vjeçar në Tiranë
21 Prill, 11:04

Kronikë

U zunë për vendin e parkimit, del videoja, momenti kur dy të rinj kërcënojnë me armë ish-efektivin në një lokal në Shëngjin
20 Prill, 21:47

Kronikë

'Pasi e qerasa me bakllava më nxori djalin në pritë', dëshmia e plotë e nënës së Endri Mustafës, lidhjet me Astmer Bilalin dhe Licin, konflikt edhe me djemtë e Paulin Radovanit
Adriatik Doci
20 Prill, 18:48

Kronikë

Vodhën pulat dhe elektro-shtëpiaket e fqinjëve në Cërrik, dy në pranga një në hetim
20 Prill, 12:08

Kronikë

Digjen dy makina gjatë natës në fshatin Bardhaj në Shkodër
20 Prill, 10:43

Kronikë

EMRAT/ Goditet grupi i shpërndarjes së drogës në Korçë! 24 të arrestuar, 7 në kërkim! Ishin nën vëzhgim prej 5 muajsh nga policia! Sekuestrohen drogë, para e radiomarrëse policie
20 Prill, 09:22

Kronikë

Plagosja e 28-vjeçarit në Shkodër, shpallet në kërkim autori! Daja i të riut i vrarë në 2014 për pazare droge! Dëshmia nga spitali: Nuk e di kush më qëlloi, erdhi nga pas
20 Prill, 09:02

Kronikë

Plagoset me armë zjarri një 28-vjeçar në Shkodër, shkon në spital me një plumb në këmbë! Shoqërohet një person (VIDEO)
19 Prill, 22:10

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje